MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

Programi mësimor

# Gjuhë angleze

## për klasën IV

Shkup, 2021

## TË DHËNA THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

| | |
|---|---|
| **Lënda mësimore** | ***Gjuhë angleze*** |
| **Lloji/kategoria e lëndës mësimore** | E obligueshme |
| **Klasa** | IV (e katërt) |
| **Temat/fushat në programin mësimor** | ● ***Bota ime e vogël: familja, shtëpia, miqtë***<br>● ***Bota ime e jashtme: shkolla, mjedisi i drejtpërdrejtë, interesat, aktivitetet e lira***<br>● ***Lagjja jonë, qyteti/fshati ynë, bota jonë***<br>● ***Planeti ynë, shëndeti ynë, ardhmëria jonë*** |
| **Numri i orëve** | 3 orë në javë/108 orë në vjet |
| **Pajisja dhe mjetet** | ● kompjuter, printer, projektor, tabelë, poster;<br>● fotografi, piktura, objekte, flesh kartela, stikerë;<br>● materiale për përpunimin e urimeve për ditëlindje/urim për ditëlindje, letër, gërshërë, letra me ngjyrë, ngjitës, blloqe, plastelinë, ngjyra të drurit, flomasterë. |
| **Normativi i kuadrit mësimor** | - studimet e përfunduara nga Gjuha angleze dhe letërsia/literatura – drejtimi mësimdhënie, VII/1 ose VIA (sipas KMK) dhe 240 SETK;<br>- studime të përfunduara nga Gjuha angleze dhe letërsia (me titull profesor i gjuhës angleze dhe letërsisë), VII/1 ose VIA (sipas KMK) dhe 240 SETK;<br>- studime të përfunduara nga Gjuha angleze dhe letërsia/literatura – drejtim tjetër dhe me përgatitje të përshtatshme të fituar pedagogjike-psikologjike dhe metodike në institucione të akredituara të arsimit të lartë, VII/1 ose VIA (sipas KMK) dhe 240 SETK;<br>- studime të përfunduara për mësim klasor me modul për gjuhën angleze – VII/1 ose VIA (sipas KMK) dhe 240 SETK;<br>- studime të përfunduara katërvjeçare të programit studimor për Gjuhë maqedonase dhe angleze (me titull të fituar profesional profesor i gjuhës maqedonase dhe angleze), VII/1 ose VIA (sipas KMK) dhe 240 SETK;<br>- studime të përfunduara në dy lëndë, gjuhë angleze dhe gjuhë tjetër, me përgatitje të përshtatshme të fituar pedagogjike-psikologjike dhe metodike në institucione të akredituara të arsimit të lartë, VII/1 ose VIA (sipas KMK) dhe 240 SETK; |

| | |
|---|---|
| | - studime të përfunduara nga gjuha angleze (me titull filolog i diplomuar), me përgatitje të përshtatshme të fituar pedagogjike-psikologjike dhe metodike në institucione të akredituara të arsimit të lartë, VII/1 ose VIA (sipas KMK) dhe 240 SETK;<br>- studime të përfunduara nga gjuha angleze në program, tjetër studimor, me përgatitje të përshtatshme të fituar pedagogjike-psikologjike dhe metodike në institucione të akredituara të arsimit të lartë, VII/1 ose VIA (sipas KMK) dhe 240 SETK. |

## LIDHSHMËRIA ME STANDARDET KOMBËTARE

Rezultatet e mësimit të renditura në programin mësimor shpijnë në përvetësimin e kompetencave të mëposhtme të përfshira me fushën ***Përdorimi i gjuhëve të tjera*** nga Standardet kombëtare:

| | *Nxënësi/nxënësja di dhe/ose është i aftë:* |
|---|---|
| II-A.1 | të kuptojë fjalitë dhe frazat e përdorura shpesh që i referohen fushave me rëndësinë më të drejtpërdrejtë personale (si informacione personale dhe familjare, nevojat dhe interesat); |
| II-A.5 | të komunikojë në situata konkrete dhe të përditshme kur kërkohet shkëmbim i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i informacionit për tema të njohura; |
| II-A.6 | t'i shqiptojë qartë dhe saktë të gjitha tingujt dhe grupet e tingujve, duke respektuar rregullat e theksimit dhe intonacionit, kur ndonjë parregullsi e mundshme nuk e pengojnë komunikimin; |
| II-A.7 | t'i përdorë deklaratat dhe fjalitë më shpesh të përdorura që rrjedhin nga përvoja e drejtpërdrejtë dhe/ose i referohen temave dhe situatave me interes të drejtpërdrejtë; |
| II-A.8 | t'i shkruajë fjalitë dhe deklaratat me saktësi relative, duke i aplikuar rregullat e drejtshkrimit; |
| II-A.9 | t'i respektojë rregullat themelore gramatikore dhe përjashtimet gjatë të shprehurit me shkrim dhe me gojë. |
| | *Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:* |
| II-B.1 | përmes të mësuarit e një gjuhe tjetër lehtësohet të mësuarit e më shumë gjuhëve dhe mundësia për të komunikuar me pjesëtarët e grupeve të ndryshme kulturore/gjuhësore; |
| II-B.3 | përmes të mësuarit e gjuhëve të tjera zhvillohet interesi dhe kurioziteti për gjuhët dhe kulturat e ndryshme; |
| II-B.4 | përmes të mësuarit e gjuhëve të tjera zhvillohet respekti për kulturat e tjera dhe përmirësohen kompetencat ndërkulturore. |

Programi mësimor gjithashtu përfshin kompetencat përkatëse në fushat e: **Shkrim-leximi digjital, Zhvillimi personal dhe social, Shoqëria dhe kultura demokratike, Teknika, teknologjia dhe sipërmarrësia,** dhe **Shprehja artistike dhe kultura** e Standardeve kombëtare.

| | *Nxënësi/nxënësja di dhe është i/e aftë:* |
|---|---|
| IV-A.2 | të vlerësojë kur dhe në çfarë mënyre është i nevojshëm edhe përdorimi efektiv i TIK për të zgjidhur një detyrë/problem; |
| IV-A.5 | të përcaktojë se çfarë informacioni i nevojitet, të gjejë, të zgjedhë dhe të shkarkojë të dhëna, informacione dhe përmbajtje digjitale; |
| V-A.4 | të bëjë vlerësim të aftësive dhe arritjet e tija/saja (duke përfshirë pikat e forta dhe të dobëta) dhe mbi atë bazë të përcaktojë prioritetet që do t'i mundësojnë atij/saj të zhvillohet dhe përparojë; |
| V-A.6 | të vendosë synime për të mësuar dhe zhvillim personal dhe të punojnë për tejkalimin e sfidave që paraqiten në rrugën drejt arritjes së tyre; |
| V-A.7 | t'i përdorë përvojat e veta për ta lehtësuar mësimin dhe për ta përshtatur sjelljen e vet në të ardhmen; |
| V-A.13 | të komunikojë me të tjerët dhe ta prezantojë veten në mënyrë të përshtatshme me situatën; |
| V-A.14 | të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë në mënyrë të përshtatshme, duke treguar empati dhe mirëkuptim për të tjerët dhe duke shprehur shqetësimet dhe nevojat e veta në mënyrë konstruktive; |
| V-A.15 | të bashkëpunojë me të tjerët në arritjen e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët dhe duke marrë parasysh pikëpamjet dhe nevojat e të tjerëve; |
| V-A.17 | të kërkojë informacion kthyes dhe mbështetje për veten, por gjithashtu të ofrojë informacione kthyese dhe mbështetje konstruktive në dobi të të tjerëve; |
| V-A.19 | të japë sugjerime, të marre parasysh mundësitë e ndryshme dhe t'i parashikoje pasojat në mënyrë që të nxjerrë përfundime dhe të marre vendime racionale; |
| V-A.21 | ta analizojnë, vlerësojë dhe përmirësojë të mësuarit e vet; |
| VI-A.2 | ta analizojë sjelljen e vet në mënyrë që të përmirësohet, duke vendosur qëllime realiste dhe të arritshme për veprim aktiv në komunitet; |
| VI-A.3 | t'i formulojë dhe argumentojë pikëpamjet e veta, t'i dëgjojë dhe analizojë pikëpamjet e njerëzve të tjerë dhe t'i trajtojë me respekt, edhe kur nuk pajtohet; |
| VI-A.5 | t'i kuptojë dallimet midis njerëzve mbi çfarëdo baze (përkatësia gjinore dhe etnike, mosha, aftësitë, statusi social, etj.); |
| VI-A.6 | ta njohë praninë e stereotipave dhe paragjykimeve mes vetes dhe të tjerëve dhe të kundërshtojë diskriminimin; |
| VII-A.9 | të marre pjesë aktivisht në punën ekipore sipas rregullave të miratuara më parë dhe me respekt të vazhdueshëm për rolin dhe kontributin e të gjithë anëtarëve të ekipit. |
| | *Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:* |
| IV-B.1 | shkrim-leximi digjital është thelbësor për jetën e përditshme – e lehtëson mësimin, jetën dhe punën, kontribuon në zgjerimin e komunikimit, krijimtarisë dhe inovacionit, ofron mundësi të ndryshme për argëtim; |

| | |
|---|---|
| V-B.3 | arritjet personale dhe mirëqenia e dikujt në masë të madhe varen nga puna që ai/ajo investon dhe rezultatet që i arrin; |
| V-B.4 | çdo veprim që e ndërmerr ka pasoja për të/saj dhe/ose mjedisin e tij/saj; |
| V-B.7 | iniciativa, këmbëngulja dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, arritjen e qëllimeve dhe tejkalimin e sfidave në situatat e përditshme; |
| V-B.8 | ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - ashtu siç ka të drejtë t'i kërkojë të tjerëve që t'i mundësojnë atij/asaj të jetë i kënaqur me interesat dhe nevojat e tij/saj, po ashtu edhe ai/ajo ka përgjegjësi t'u japë hapësirë të tjerëve për të kënaqur interesat dhe nevojat e tyre; |
| V-B.9 | kërkimi i informacionit kthyes dhe pranimi i kritikës konstruktive çon në përparim personal në planin individual dhe social; |
| VI-B.2 | të gjithë njerëzit, duke përfshirë fëmijët, kanë të drejtë të shprehin opinionet dhe pikëpamjet e tyre dhe të marrin pjesë në vendimmarrjen që lidhet me nevojat dhe interesat e tyre; |
| VIII-B.4 | diversiteti kulturor ndikon në zhvillimin e identitetit të pjesëtarëve të kulturave të ndryshme; |
| VIII-B.5 | dallimet ndërkulturore duhet të shihen si mundësi për të mësuar dhe si një sfidë për mirëkuptimin dhe përparimin reciprok; |
| VIII-B.6 | respektimi dhe promovimi i kulturave të tjera kontribuon në sigurimin e respektit për kulturën e vet nga të tjerët. |

## REZULTATET E MËSIMIT

Tema: ***BOTA IME E VOGËL, FAMILJA, MIQTË***
Numri i përgjithshëm i orëve: **27**

**Rezultatet e mësimit**

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. prezantojë veten, familjen më të ngushte dhe më të gjerë, shtëpinë dhe miqtë, në një bisedë joformale, duke përdorur përemra dëftor dhe mbiemra pronor;
2. lexojë dhe kuptojë deklarata të shkurtra dhe/ose dialogë të shkurtër që lidhen me familjen më të ngishte dhe më të gjerë, shtëpinë dhe miqtë;
3. kuptojë kuptimin e një numri të caktuar fjalësh dhe i përdor ato në një kontekst të përshtatshëm në një bisedë joformale (anëtarët e familjes, mobilet e shtëpisë dhe ndajfolje për vend: *in, on, under, behind, in front of, above*);
4. përdor alfabetin anglez gjatë formulimit të fjalive të shkurtra dhe/ose dialogë të shkurtër që lidhen me familjen e ngushtë dhe më të gjerë, shtëpinë dhe miqtë në formë të shkruar.

| **Përmbajtjet (dhe konceptet)** | **Standardet e vlerësimit** |
|---|---|
| a) Funksionet gjuhësore:<br>● prezantimi i miqve: *Hello, I'm Iva! This is my friend. Her name's Zara.*<br><br>*A: How old is Zara?*<br>*B: She is 9 years old.*<br><br>● prezantimi i shtëpisë: *What is this? / This is my building. / This is my cousin's house. / This is a red sofa. /This is a brown chair. / The lamp is on the cupboard. / The toys are under the bed. / My brother is behind the door.* | ● I prezanton anëtarët e familjes së vet më të ngushtë dhe më të gjerë, shtëpinë dhe miqtë në një mënyrë joformale në një deklaratë të shkurtër të dhënë ose dialog që përmban ndajfolje vendi.<br>● Merr pjesë në një dialog të shkurtër për të prezantuar miqtë, anëtarët e familjes, fqinjët, duke formuluar fjali të shkurtra që përmbajnë mbiemra pronor, përemër dëftor (*this*) dhe forma e foljes *TO BE* në *Present Simple Tense*.<br>● I përgjigjet pyetjeve të thjeshta të shkurtra që lidhen me familjen, shtëpinë dhe miqtë në një kontekst të përshtatshëm.<br>● E përshkruan vendndodhjen e objekteve në shtëpi, duke përdorur ndajfolje vendi.<br>● E përdor alfabetin anglez për të shqiptuar emrin e tij. |
| b) Njësitë leksikore:<br>● familja dhe miqtë: *boy, girl, friend, cousin, niece, nephew, neighbour;* | ● I emëron anëtarët e familjes më të ngushtë dhe më të gjerë dhe miqtë.<br>● I emëron dhe i numëron objektet në shtëpi.<br>● I përsëritë dhe i lexon njësitë leksikore me shqiptim dhe theksim të drejt.<br>● I/e aplikon rregullta drejtshkrimore q[ë të shkruajë fjali të shkurta të cilat i përmbajnë njësitë leksikore e përvetësuara. |

| | |
|---|---|
| ● shtëpia dhe mobilet: *house, building, apartment, floor, garden, yard, chair, sofa, cupboard, lamp, toy;*<br>● mbiemra: *clean, dirty, beautiful, nice, new, old, modern*;<br>● ndajfolje vendi: *in, on, under, behind, between, above, next to, in front of.* | ● Përshkruan mobilet në shtëpi, duke përdorur mbiemra në kontekstin adekuat.<br>● Bën dallimin e rëndësisë së ndajfoljeve të vendit: *in, on, under, behind, between, above, next to, in front of* në deklarata të shkurta. |
| c) Struktura gramatikore:<br>● përemra dëftor: *This is…;*<br>● përemra pronor: *my/your/his/her/its;*<br>● pronësia te emrat në njëjës: *cousin's house, friend's name;*<br>● forma të gjata dhe të shkurta të foljes *TO BE* në *Present Simple Tense*: *am/'m, is/'s, are/'re.* | ● Formulon fjali të shkurta me përemrin dëftor *this* në formë të shkruar dhe gojarisht.<br>● Bën dallimin e përemrave pronor për vetën e parë, të dytë dhe të tretë njëjës në komunikimin me shkrim dhe gojarisht.<br>● Njeh pronësi te një numër i kufizuar i emrave në njëjës: *friend's name, cousin's house*.<br>● Përdor forma të gjatë të foljes *TO BE* në *Present Simple Tense* në përgjigje të shkurta në formën pohuese.<br>● Përdor forma të shkurtra të foljes TO BE në Present Simple Tense në përgjigje të shkurtra në formë mohuese.<br>● Formulon pyetje të thjeshta me foljen *TO BE* në *Present SimpleTense* në formën e shkruar dhe gojarisht.<br>● E dallon mbiemrin pronor për vetën e tretë njëjës (*its*) nga forma e shkurtër e foljes *TO BE* në vetën e tretë njëjës (*it's*). |
| ç) Përmbajtje ndërkulturore:<br>● *Halloween: Happy Halloween! Trick or treat! candy, pumpkin, candle, pumpkin pie, turkey, mashed potatoes and cranberry sauce, halloween costumes*;<br>● *Thanksgiving: Happy Thanksgiving! dinner, turkey;*<br>● *Depictions of boys and girls in the media (stereotyping, TV): Only girls play with dolls. All boys love football. Is this true?*<br>*Oh, his T-shirt is red. Is red colour good for boys?* | ● Njeh specifika lidhur me festat e përvetësuara dhe dallimet kulturore.<br>● Përdor shprehje/fraza të përvetësuara për të uruar festa.<br>● E uron *Halloween*, duke përdorur mesazhe të thjeshta.<br>● Riprodhon dhe prodhon në mënyrë të pavarur në formë gojore dhe të shkruar njësi leksikore të mbizotëruara mbi një temë që lidhet me festën e *Thanksgiving.*<br>● Dallon deklaratën e saktë auditive nga ajo e pasaktë në shembuj të situatave stereotipike.<br>● Përgjigjet në pyetje/deklarata të thjeshta sipas modelit të njohjes së shembujve për stereotipa. |

**Shembuj për aktivitete**

- Mësuesi tregon një fotografi ose imazh elektronik të shokut/fqinjit/anëtarit të familjes dhe e prezanton atë (*This is my nephew. His name is Jovan. He is 10. He is from Ohrid.*), dhe pastaj nxënësit luajnë role duke prezantuar sipas të njëjtin parim.
- Nxënësi formulon fjalë të thjeshta nga shkronjat e dhëna me një renditje të përzier.
- Mësuesi e lëshon një audio regjistrim dhe/ose lexon një përshkrim të shtëpisë dhe sendeve në shtëpi (*Where is the sofa? The sofa is in the living room. Where is the cupboard? The cupboard is in the kitchen*.).
- Nxënësit hartojnë/shkruajnë një dialog të shkurtër autentik të bazuar sipas modelit të dhënë dhe e realizojnë dialogun para të gjithë klasës (nxënësit lexojnë një model dialog sipas roleve të dhëna).
- Nxënësit përshkruajnë një fotografi të një dhome në mënyrë alternative duke e përdorur përemrin dëftor *This is* dhe ndajfoljet e vendit: *in, on, under, behind.…* me ngjyrën adekuate të objektit dhe vendndodhjen e tij (*The new chair is behind the desk./ This is a modern blue lamp. The blue lamp is on the desk.*)
- Nxënësit shkruajnë deklarata të shkurtra, duke përdorur fjalorin e duhur në lidhje me familjen dhe miqtë, shtëpinë dhe mobilet.
- Nxënësit shkruajnë fjalë të sendeve në shtëpi copa letre të vogla, pastaj i ngjisin në një letër për ta prezantuar vendndodhjen e tyre në dhomë.
- Mësuesi përgatit një kuiz me pyetje të llojit të vërteta/të rreme dhe nxënësit u përgjigjen pyetjeve.
- Nxënësit e dëgjojnë dhe e këndojnë këngën *Go away!* si një ilustrim i Halloween.
- Mësuesi përgatit kartela me sfida për lojën Trick or treat! (shembull për kartela: *Go find 3 orange things! Walk like a zombie!*), ku nxënësit zgjedhin një kartelë, e lexojnë me zë të lartë dhe e përfundojnë sfidën.
- Nxënësit përgatisin urime për ditëlindje.
- Nxënësit e dëgjojnë dhe e këndojnë këngën *Boy or Girl Colour* me qëllim që të tejkalohet lidhja stereotipe e ngjyrave me gjininë.

Tema: ***BOTA IME E JASHTME: SHKOLLA, MJEDISI I DREJTPËRDREJTË, INTERESAT, AKTIVITETET E LIRA***
Numri i përgjithshëm i orëve: **27**

**Rezultatet e mësimit**

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë të:

1. diskuton për shkollën në të cilën ai/ajo mëson dhe mjedisin e drejtpërdrejtë;
2. shpreh interesa personale, të flasë për hobi dhe aktivitetet e tij të lira, duke formuluar deklarata të shkurtra;
3. përdor një numër të caktuar kolokimesh të përdorura shpesh në të shprehurit me shkrim dhe me gojë;
4. i shkruan numrat nga 1 deri në 50 me fjalë, ditët e javës, të përdorë shumësin e saktë të një numri të caktuar emrash në komunikimin me shkrim dhe me gojë, si dhe format pyetëse, pohuese dhe mohuese (të gjata dhe të shkurtra) te folja have got.

| **Përmbajtjet (dhe konceptet)** | **Standardet e vlerësimit** |
|---|---|
| a) Funksionet gjuhësore:<br>● i prezanton aktivitetet shkollore dhe bisedon për jetën/qëndrimin në shkollën ku mëson: *I love my school. / I do my homework every day.*<br>*This is her playground./ That is my pencil case. / These are his books./ Those windows are from our school gym.*<br>*There are twenty two chairs in the classroom.*<br>● Hulumtimi i dëshirave dhe interesave personale, hobi dhe aktivitetet e lira:<br>*A: My favourite sport is handball. / I want to become a famous football player.*<br>*B: What is your favourite handball team? / Who is this tennis player?*<br>*In my free time, I go to Vodno with my friends.*<br>*Bob plays video games in his free time. His favourite game's Apex Legends and Fortnite: Battle Royale.*<br>*I read a lot of books in my free time. My favourite book is Pippa's Island.*<br>*Sarah plays the piano. She's very gifted.* | ● Flet për shkollën ku ai/ajo mëson, si dhe për mjedisin e drejtpërdrejtë në një mënyrë joformale duke dhënë një deklaratë të shkurtër duke përdorur përemrat dëftor të përshtatshëm për të vënë në dukje objektet.<br>● Merr pjesë në dialog duke bërë dhe/ose duke iu përgjigjur pyetjeve të shkurtra që lidhen me dëshirat ose interesat personale.<br>● Përshkruan hobi dhe aktivitete që bën në kohën e tij të lirë, duke përdorur deklarata të shkurtra. |
| b) Njësitë leksikore:<br>● shkolla dhe interesat: *classroom, white/interactive board, markers, team, group work, sport, player, hobby, present, mountain, pet, computer games, video games, ride a bike, free time;*<br>● kolokacione: *do my homework, take a photo/selfie, write a story, play (computer/video)* | ● Emëron gjërat/termet që janë pjesë e mjedisit shkollor dhe/ose mjedisit të afërt, duke përdorur deklarata të shkurtra me leksikun e sapo mësuar.<br>● Lidh një numër kolokimesh për të shprehur aktivitetet me një paraqitje ilustruese të dhënë.<br>● Përdor një numër kolokimesh të reja të përvetësuara për të përshkruar aktivitetet shkollore dhe të lira me gojë dhe me shkrim.<br>● Formulon deklarata të shkurtra që përmbajnë ditët e javës në korrelacion me një aktivitet të caktuar shkollor ose argëtimi ose hobi. |

| | |
|---|---|
| *games, play the piano/guitar, use a computer; finish a school project, read a book, send an email;*<br>● ditët e javës: *Monday, Tuesday, Wednesday, Thursday, Friday, Saturday, Sunday.*<br>*They have English classes on Monday. She has a football match on Wednesday.* | ● Zbaton rregullat drejtshkrimore dhe shenjat e pikësimit në deklarata të shkurtra me shkrim që përmbajnë ditë të javës dhe/ose bashkërenditje për shprehjen e aktiviteteve.<br>● Dallon kuptimin e një numri të caktuar foljesh në një tërësi ose kolokacion të dhënë gjuhësor. |
| c) Strukturat gramatikore:<br>● përemrat dëftor *(this desk/that chair; these boys/those girls)*;<br>● numra prej 1 deri 50;<br>● mbiemrat: *favourite, clever, smart, gifted, happy - sad, good - bad, tall - short*;<br>● shumësi i drejt te emrat: *school - schools; classroom - classrooms, book - books, pencil - pencils;*<br>● nyejt te emrat: *a pen, a friend, a teacher, an email, the guitar, the violin*;<br>● forma pyetëse, pohuese dhe mohuese (të gjata dhe të shkurta) nga folja *have got* në të gjitha vetat (*haven't got, hasn't got*). | ● Dallon kuptimin e përemrave dëftor sipas afërsisë/distancës së objekteve dhe personave në raport me personin që flet.<br>● Përdor një përemër dëftor të përshtatshëm kur përshkruan vendndodhjen e objekteve në klasë/shkollë/mjedisin e afërt, si dhe një nyje specifik para veglave muzikore.<br>● Formulon një deklaratë të shkurtër që lidhet me shkollën dhe/ose mjedisin e drejtpërdrejtë, duke përdorur numrin e duhur dhe përemrat dëftor në shumës.<br>● Lidh mbiemrat me kuptim të kundërt në një deklaratë ose dialog të shkurtër të dhënë.<br>● Formulon një deklaratë të shkurtër që përmban një mbiemër për të përshkruar një person ose objekt.<br>● Dallon emrat njëjës dhe shumës në komunikimin me shkrim dhe me gojë.<br>● Zbaton rregullat drejtshkrimore kur shkruan një nyje të pacaktuar në emrat njëjës, si dhe kur shkruan fjalë me numra dyshifrorë deri në 50.<br>● Përgjigjet dhe bën pyetje të shkurtra, duke përdorur formën e përshtatshme të foljes *HAVE GOT*. |
| ç) Përmbajtjet ndërkulturore:<br>● urimi dhe kremtimi i festave:<br>*Happy New Year! Happy Christmas/Merry Christmas; Happy holidays! We wish you a Merry Christmas, We wish you a Merry Christmas and a Happy New Year!* | ● Njeh specifikat që lidhen me urimet e Krishtlindjeve;<br>● Përdor shprehje/fraza të përvetësuara karakteristike për Krishtlindjet dhe Vitin e ri dhe për të shprehur një dëshirë të Vitit të ri kur shkruan një kartolinë të Vitit të ri;<br>● Merr pjesë në një bisedë të shkurtër me temën *Të drejtat e fëmijëve* me një leksik të sapo mësuar. |

| | |
|---|---|
| *Christmas present, Christmas tree, Christmas Eve, Santa Claus, reindeers, chimney, send a Christmas card*;<br><br>● njohja me të drejtat e fëmijëve (hyrje):<br><br>*All kids are equal! Every child has the right to play! I have a right to relax and play!* | |

**Shembuj për aktivitete**

- Nxënësit luajnë lojëra për të praktikuar fjalorin e sapo mësuar. Për shembull, në tema të tilla si: *"Free time activities/ classroom/days of the week"*, duke përdorur një hartë mendore/rrjetë merimange, disa nxënës thonë fjalë dhe të tjerët i shkruajnë ato në vende të veçanta.
- Mësuesi shpërndan fletë në të cilat ditët e javës shkruhen në një renditje të përzier shkronjash. Nxënësit gjejnë rendin e saktë të shkronjave dhe shkruajnë fjalën.
- Nxënësit luajnë *Number bingo*, ku mësuesi që shpërndan kartelat bingo me numra deri në 50 dhe shpjegon rregullat e lojës. Pastaj një nxënës thotë numra deri në 50 dhe të tjerët plotësojnë kartelat e bingos. Nxënësi që e plotëson një rresht së pari bërtet "Bingo!" dhe i lexon numrat nga rreshti.
- Nxënësit garojnë për të thënë pa gabime frazën e shkurtër/të thjeshtë të shpejtë: *"Not these things here, but those things there"* për të praktikuar shqiptimin e përemrave dëftor në shumës.
- Mësuesi jep një tekst të shkurtër me fjalë të lëshuara mbi temën: *hobby/interests/free time activities* dhe ditët e javës, dhe nxënësit identifikojnë fjalët dhe shprehjet e dhëna në kontekst dhe i shkruajnë ato në vendin e duhur. *I play the ……….(guitar) on …………(Saturday)*.
- Nxënësit i lidhin dhe i emërtojnë mbiemrat që e përshkruajnë objektin e treguar në fotografi/poster dhe i shkruajnë në fletoret e tyre.
- Nxënësit, në dyshe, luajnë një lojë të bazuar në parimin "Dëgjimi i deklaratave dhe përgjigjja e tyre me gjeste dhe vizatime". Një nxënës me mimikë/pantomimë luan (*play tennis*) dhe nxënësi tjetër e shkruan atë në tabelë.
- Disa nxënës krijojnë një kuiz me pyetje në lidhje me temat që i mësojnë, dhe të tjerët u përgjigjen pyetjeve me saktë/jo e saktë.
- Mësuesi tregon fotografi/postera me temën e *New Year's Eve* në të cilat nxënësit duhet t'i gjejnë dhe t'i shkruajnë fjalët nën fotografinë e duhur.
- Nxënësit e dëgjojnë dhe këndojnë/luajnë karaoke për këngën *Santa, Santa, high in the sky*.
- Nxënësit bëjnë dekorime të Krishtlindjeve dhe Vitit të ri dhe i emërtojnë ato, pastaj formulojnë fjali duke përdorur fjalorin e përvetësuar.
- Nxënësit diskutojnë pas një videoje të shkurtër mbi temën e të drejtave të fëmijëve - e drejta për të luajtur.

Tema: ***LAGJJA JONË, QYTETI/FSHATI YNË, BOTA JONË***
Numri i përgjithshëm i orëve: **27**

**Rezultatet e mësimit**

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. ta përshkruajë vendbanimin me objekte të rëndësishme dhe terma gjeografike në deklarata të shkurtra në formë gojore dhe të shkruar;
2. të emërtojë kombësitë dhe vendet dhe të aplikojë një leksikon për pikat e referimit dhe ushqimet tradicionale nga vende të ndryshme në formë gojore dhe të shkruar;
3. të diskutojë mbi aktivitetet e përditshme dhe të shpeshta, duke formuluar fjali të shkurtra në *Present Simple Tense* që përmbajnë një ndajfolje kohe;
4. të përdor saktë shkronjat dhe pikësimet angleze kur formulon fjali të shkurtra dhe dialogë të shkurtër të shkruar, duke përdorur një numër foljesh në *Present Simple Tense* në të gjitha format dhe për të gjithë vetat, të shkruajë me fjalë numra nga 50 në 100, si dhe numra rendorë deri në 10.

| **Përmbajtjet (dhe konceptet)** | **Standardet e vlerësimit** |
|---|---|
| a) Funksionet gjuhësore:<br>● emëron shtete dhe kombësi:<br>*A: Where are you from?*<br>*B: I am from the UK (Great Britain). I am British. How about you, where are you from?*<br>*A: I am from Skopje, North Macedonia. I am Macedonian.*<br>*Their home country is Italy. They are Italian.*<br>● përshkruan vendbanimin dhe objektet më të rëndësishme në vendbanim:<br>*This is my neighbourhood. I live on Hill Street. My house number is 65.*<br>*That is my apartment block over there. This is a hospital and this is a bank. I love that new bookstore.*<br>*A: Does she like her town?*<br>*B: Yes, she does. / No, she doesn't.* | ● Emërton vende të ndryshme në Evropë dhe botë, si dhe kombësi të ndryshme.<br>● Lexon dhe kupton tekst të shkurtër me përshkrimin e vendit që përmban mbiemra pronor dhe përshkrues.<br>● Përpilon deklarata/fjali të shkurtra për ta përshkruar vendbanimin.<br>● Përdor fjali të papërcaktuara në njëjës dhe shumës për të përshkruar objekte dhe pika referimi më domethënëse në vendbanimin e vet.<br>● Merr pjesë në një dialog të shkurtër për të përshkruar vendbanimin, ndërtesat dhe pikat e referimit më të rëndësishme, si dhe aktivitetet e përditshme në vendbanim. |

| | |
|---|---|
| *A: Where is the house?*<br>*B: The house is on Hill Street. It's the first house next to the library.*<br>*A: Who lives here?*<br>*B: Ann lives here.*<br>*A:Where does her aunt live?*<br>*B: She lives in New York.*<br>*A: Is there a supermarket on our street?*<br>*B: Yes, there is. It's closed now.*<br>*The capital of England is London.*<br>*There is a big square in Skopje.*<br>*Are there a lot of houses in your neighbourhood?*<br>● përshkrimi i aktiviteteve të përditshme në vendbanim:<br>*A: Does he always go to the supermarket?*<br>*B: No, he doesn't. His sister sometimes goes to the supermarket.*<br>*They usually ride their bikes in the park.*<br>*Our grandmother lives in a village near our town. We often visit her.*<br>*A: Do you always go to the hospital when you are sick?*<br>*B: Yes, I do, sometimes. / No, I don't.* | |
